

VENDIM
Nr. 325, datë 15.12.2025

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR
ME KËRKESËN E SHOQËRISË “AGE ERZEN” SHPK PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETEVE TË SAJ SI MJET PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2677/2 prot., datë 13.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘AGE Erzen’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për autorizim

- Shoqëria “AGE Erzen” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.7.2024, nga HEC “Hekali” me kapacitet prodhues 1.94 mw, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- Me shkresën nr. 2430/2 prot., datë 22.9.2025, shoqëria ka paraqitur kërkesë/dokumentacion, në lidhje me kërkesën për miratim të transferimit të aseteve që i shërbejnë për kryerjen e veprimtarisë së licencuar, për të përmbushur detyrimin ndaj Banka OTP Albania sh.a.

2. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 251, datë 8.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 2430/6 prot., datë 16.10.2025 dhe MIE-n nëpërmjet shkresës nr. 2430/14 prot., datë 31.10.2025, në lidhje me këtë vendim.

3. Procedura vijuese dhe vlerësimi i dokumentacionit

- Me shkresën nr. 2430/6 prot., datë 16.10.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në këtë aplikim.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2430/9 prot., datë 24.10.2025, depozitoi dokumentacion/informacion shtesë, nga analizimi i të cilit u konstatua mungesa e listës së detajuar të aseteve fikse me vlerat përkatëse dhe totale të tyre.

- ERE, me shkresën nr. 2430/13 prot., datë 31.10.2025, njoftoi shoqërinë mbi zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 5.11.2025, për të sqaruar sa munguar në këtë aplikim.

- Shoqëria me shkresën nr. 2430/17 prot., datë 2.12.2025, sqaron se nuk disponon një listë asetesh, e se do të ketë një të tillë vetëm pas përfundimit të ndërtimit, kolaudit, testimit të veprës.

- Si e tillë, ERE vlerësoi të nevojshme komunikimin me bankën për të sqaruar/rakorduar me sa deklaruar nga ana e subjektit, ndaj nëpërmjet *email*-it të datës 9.12.2025, protokolluar me nr. 2430/18 prot., datë 9.12.2025, i ka kërkuar bankës sqarim/të bëjë me dije nëse disponojnë një listë asetesh si pjesë integrale e kontratave të nënshkruara.

- Banka në përgjigje me *email*-in e datës 11.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 2430/19 prot., datë 11.12.2025, ndër të tjera referon, se: informacion me të detajuar për sa i përket vlerës së investimit që pritet të kryhet nga shoqëria për realizimin e HEC “Hekali”, specifikon se mund të vihen në dispozicion nga vetë shoqëria, si dhe se në të dyja kontratat u referohet aseteve të tashme e të ardhshme, duke i vënë një vlerë sipas projektit financiar të përcjellë nga shoqëria.

4. Zgjatja e vendimmarrjes së Bordit

- Për të gjitha sa më sipër vlerësohet të bëhen sqarimet përkatëse me subjektin kërkuar dhe bankën, në lidhje me procedurën që ndjek/trajton ERE në kuptim të akteve ligjore dhe nënligjore, ndaj vlerësohet të zgjatet me 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “AGE Erzen” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “AGE Erzen” sh.p.k. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese. Brenda 20 ditëve duhet të plotësohet informacioni/dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “AGE Erzen sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

2. Brenda 20 ditëve duhet të plotësohet informacioni/dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “AGE Erzen” sh.p.k. dhe “Banka OTP Albania” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti